



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 9 datë 30/04/2014

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE (PJESA TRETË + PJESA KATËR + PJESA PESTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE PËR TË CILAT BASHKIA E TIRANËS KËRKON TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË SAJ”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 1/II, shkronja “a” dhe “c” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr.3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”; pika 1/a, të udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr.15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Listës Paraprake (pjesa e tretë+pjesa e katërt+pjesa e pestë) të Pronave të Paluajtshme Shtetërore për të cilat Bashkia Tiranë kërkon transferimin në pronësi të saj sipas listës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Paraqitjen e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme sipas pikës 1 të këtij vendimi për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike (Sektori i Inventarit dhe Regjistrimit të Pronave Publike).
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI